



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 12

20 shkurt

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 7941 datë 5.2.2013	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 355
Vendim i KM nr. 32, datë 23.1.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, të ndryshuar..... 355
Vendim i KM nr. 90, datë 6.2.2013	Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2013, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare..... 361
Vendim i KZHR nr. 1, datë 7.2.2013	Për financimin e projekteve në zbatim të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve..... 361
Urdhër i MB nr. 87, datë 1.2.2013	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe veprimeve që duhet të kryejnë nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve”..... 369
Vendim i ERE nr. 6, datë 23.1.2013	Mbi ankandin e muajit shkurt 2013 të kapaciteteve të interkonjeksionit..... 379
Vendim i ERE nr. 7, datë 29.1.2013	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “Hec Verba 1” dhe “Hec Verba 2” si burim i rinovueshëm energjie..... 379
Vendim i ERE nr. 8, datë 29.1.2013	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “A&A Group” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.... 380

Vendim i ERE nr. 9, datë 30.1.2013	Mbi organigramën e re të shoqërisë “Cez Shpërndarje” (nën administrim të përkohshëm) të propozuar për miratim ERE-s.....	381
Vendim i ERE nr. 10, datë 30.1.2013	Për licencimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	383
Vendim i ERE nr. 11, datë 30.1.2013	Për licencimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	383
Vendim i ERE nr. 12, datë 30.1.2013	Për licencimin e shoqërisë “Truen” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	384
Vendim i ERE nr. 13, datë 30.1.2013	Për licencimin e shoqërisë “Truen” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Truen”.....	385
Vendim i ERE nr. 14, datë 30.1.2013	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Wonder” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	386
Vendim i ERE nr. 15, datë 30.1.2013	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “Wonder” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike...	387
Vendim i ERE nr. 16, datë 30.1.2013	Për fillimin e procedurave për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike me seri pv10k, nr. 112, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 110, datë 22.12.2010 për shoqërinë “Energy Plus” sh.p.k.....	388
Vendim i KKRT nr. 15, datë 18.1.2013	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio 1”.....	389
Vendim i KKRT nr. 34, datë 1.2.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Shijak”.....	389

DEKRET
Nr. 7941, datë 5.2.2013

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------|--|
| 1. Astrit Skënder Xhelili | 15. Edon Oltion Mehmetaj |
| 2. Albano Samir Bujar Bonaj | 16. Manjola Xhevair Gödeoglan (Krasniqi) |
| 3. Doris Nikalin Prifti | 17. Laureta Enver Fatsis (Kurmaku) |
| 4. Dorian Vasil Nupen (Doja) | 18. Thanat Alfred Jørgensen (Çavo) |
| 5. Violeta Avdyl Rexha (Rexhaj) | 19. Ildir Spiro Peçi |
| 6. Klaus Kujtim Shabani | 20. Orneta Thanat Dhima-Konçi (Dhima) |
| 7. Jorgji Ilia Kojat | 21. Besnik Selim Biba |
| 8. Xhulio Dashamir Bejkollari | 22. Ilda Bardhosh Grüttner (Micaj) |
| 9. Aida Islam Bali (Cani) | 23. Lumturi Sali Daka (Gjoni) |
| 10. Alina Agustin Cane | 24. Nasije Fadil Gega (Gjepali) |
| 11. Sulejman Agustin Cane | 25. Alsied Esat Gega |
| 12. Sebastian Agustin Cane | 26. Kejda Besnik Krauß (Nelaj) |
| 13. Kajan Petrit Kajo | 27. Julia Franko Bechtloff (Kroqi) |
| 14. Esra Kajan Kajo | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 32, datë 23.1.2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 1, DATË 10.1.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROKURIMIN
PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në tekstin “Rregullat për prokurimin publik”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun 1 “Organizimi i prokurimit publik”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, fjalët “... të vëna në dispozicion të tij ...” hiqen.

b) Në pikën 3 “Buletini i Njoftimeve Publike”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i) Pas paragrafit të dytë të shkronjës “b”, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përgatitja dhe dorëzimi i regjistrin vjetor të parashikimeve sipas afateve të mësipërme, nuk pengon shpalljen e procedurave të prokurimit nga autoritetet kontraktore përpara këtyre afateve.”.

ii) Fjalja e parafundit e paragrafit të parë të shkronjës “ç”, riformulohet si më poshtë vijon:

“Shpallja e njoftimit të fituesit në faqen në internet të APP-së do të bëhet publike ditën e nesërme të punës nga dita e hedhjes së njoftimit në sistem.”.

iii) Paragrafi i dytë dhe i tretë në shkronjën “ç”, shfuqizohen.

iv) Në fjalinë e fundit të shkronjës “dh”, “Regjistri Kombëtar i Realizimit të Prokurimeve Publike”, fjala “... raportin ...” zëvendësohet me “... regjistrin ...”.

2. Në kreun II “Rregulla të përgjithshme të prokurimit”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja “b” e pikës 1 riformulohet si më poshtë vijon:

“b) Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave brenda një viti kalendarik nuk është më e madhe se 400 000 (katërqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlera të vogla, siç përshkruhet në kreun VI të këtyre rregullave.

Për veprimtari të përcaktuara në ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, vlera e përllogaritur e prokurimeve me vlerë të vogël për artikuj apo grup artikujsh brenda një viti kalendarik të jetë nën vlerën e kufirit të ulët monetar.”.

b) Në shkronjën “ç” të pikës 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, pas fjalëve “... në çdo rast ...” shtohen fjalët “... përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit ...”.

3. Në kreun III “Dokumentet e tenderit”, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1 “Dokumentet standarde të tenderit”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Shkronja “a” riformulohet si më poshtë vijon:

“a) APP-ja përgatit formatin e dokumenteve standarde të tenderit, që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit. Këto dokumente japin informacion që ka lidhje me objektin e kontratës dhe llojin e procedurës, i cili plotësohet, në çdo rast, nga autoritetet kontraktore. Gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike. Autoriteti kontraktor, kur i kërkohet nga operatorët ekonomikë, do të vërë në dispozicion të të interesuarve dokumentet e tenderit, kundrejt pagesës. Në çdo rast, emrat dhe numri i operatorëve ekonomikë, që kanë shfaqur interes për blerjen e dokumentacionit të tenderit apo këqyrjen e tij, duhet të mbahen sekret.”.

ii) Nënparagrafi i nëntë i shkronjës “b” ndryshohet si më poshtë vijon:

“Formularin e njoftimit të kontratës së lidhur.”.

b) Në pikën 2 “Informacion i përgjithshëm”, bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

i) Pas paragrafit të pestë të shkronjës “c” “Udhëzimet për kandidatët/ofertuesit”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Çmimet e dhëna nga ofertuesi duhet të jenë të fiksuara përgjatë ekzekutimit të kontratës dhe nuk duhet t’i nënshtrohen asnjë ndryshimi në asnjë aspekt. Oferta e paraqitur me çmim të

ndryshueshëm dhe që nuk është në përputhje me këtë paragraf do të refuzohet nga autoriteti kontraktor si e papranueshme.”.

ii) Në paragrafin e dytë të shkronjës “e”, “Formulari i sigurimit të ofertës”, fjalja “Tërheqja e ofertave nga ofertuesit e klasifikuar i dyti e me radhë, pas klasifikimit nuk ndikon në vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së prokurimit nga autoriteti kontraktor.”, shfuqizohet.

iii) Në shkronjën “f” “Formulari i njoftimit të fituesit”, bëhen këto shtesa:

- Në fjalinë e tretë, pas fjalëve “... arsyet e skualifikimit ...” shtohen fjalët “... informacion nëse ka pasur ankesa ...”.

- Në fund të shkronjës “f” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Autoriteti kontraktor do të ftojë operatorin ekonomik të shpallur fitues që të lidhë kontratën menjëherë pas publikimit të njoftimit në sistem, por, në çdo rast, jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e këtij publikimi. Operatori ekonomik i shpallur fitues është i detyruar t’i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor brenda 5 (pesë) ditëve.”.

iv) Në shkronjën “g” bëhen këto ndryshime:

- Emërtimi i shkronjës “g” zëvendësohet me: “Formulari i njoftimit të kontratës së lidhur”.

- Në fjalinë e fundit pjesëza “nuk” hiqet.

c) Në pikën 4 “Kriteret për vlerësimin e ofertës”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i) Fjalja e fundit e shkronjës “b” riformulohet si më poshtë vijon:

“Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 (pesëdhjetë) pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 (njëqind).”.

ii) Shkronja “c” riformulohet si më poshtë vijon:

“c) Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter, d.m.th., sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.”.

4. Në kreun IV “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, pas fjalisë së fundit të paragrafit të dytë të shkronjës “b” të pikës 4 “Procedura me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Në këtë rast, urdhri i prokurimit nuk përmban fondin limit.”.

5. Në kreun IV/A “Prokurimi i kontratave sektorale”, në fjalinë e dytë të pikës 3.4 “Uji i pijshëm”, fjalët “... më tepër ...” zëvendësohen me “... jo më tepër ...”.

6. Në kreun IV/B “Marrëveshja kuadër”, në fjalinë e fundit të pikës 3, pjesëza “nuk” hiqet.

7. Në kreun V “Zhvillimi i procedurave”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1 “Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i) Në fund të shkronjës “a” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. ”.

ii) Në shkronjën “c” fjalët “... mirëmbajtjen e regjistrit zyrtar të zbatimit të procedurave ...” zëvendësohen me “... administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit ...”.

iii) Shkronja “ç” riformulohet si më poshtë vijon:

“ç) Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe kur ka nevojë për punë, mallra dhe shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë të paktën:

- objektin e prokurimit;

- fondin e përlllogaritur;

- llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj;



- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit në këtë rast do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në shkronjën “f” të pikës 2 të kreut III dhe vetëm pasi fondet do të jenë në dispozicion (në llogaritë përkatëse) të autoriteteve kontraktore.”.

b) Në fjalinë e dytë të shkronjës “a” të pikës 2 “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, pas fjalëve “... kriteret e vlerësimit, ndërsa ...” shtohen fjalët “... përlllogaritja e vlerësimit të kontratës ...”.

c) Pas paragrafit të tretë të shkronjës “a” të pikës 3 “Dorëzimi i ofertave”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në rast se në momentin e hapjes së ofertave evidentohet se një ose disa prej operatorëve ekonomikë ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohet përpara këtij momenti, atëherë duhet të zëvendësohet zyrtari/zyrtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procesi i prokurimit.”.

ç) Në pikën 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i) Pas paragrafit “b/2” të shkronjës “b”, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“b/3” Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ndalohet të kualifikojë operatorët ekonomikë, që, sipas ligjit për prokurimin publik, janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktor/nëkontraktor, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t’u lidhur, në përputhje me ligjin për prokurimin publik, për furnizimin/blerjen e ushqimeve të freskëta në subjekte të tjera shtetërore, për të cilat në çastin e hapjes së ofertave nuk ka përfunduar kontrata në masën 70 për qind. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ku secili prej tyre, për t’u kualifikuar, duhet të ketë përfunduar kontratat në masën 70 për qind të vëllimeve të përgjithshme të furnizimeve, që ai ka marrë përsipër të realizojë, në përputhje me kontratën e bashkëpunimit.”.

ii) Nënndarja e dytë e paragrafit të dytë të shkronjës “ç”, riformulohet si më poshtë vijon:

“Nëse ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.”.

iii) Në fjalinë e parë të shkronjës “dh”, pas fjalëve “... me negocim ...” shtohen fjalët “... me shpallje ...” dhe në fjalinë e fundit të po kësaj shkronje, fjalët “... pas 5 (pesë) ditëve ...” zëvendësohen me fjalët “... pas 7 (shtatë) ditëve ...”.

iv) Shkronja “ë” riformulohet si më poshtë vijon:

“ë) Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 40 për qind e fondit limit të përlllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 80 për qind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së.”.

d) Fjalja e dytë e shkronjës “gj” riformulohet si më poshtë vijon:

“Komisioni i vlerësimit pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon, për miratim, titullarit të autoritetit.”.

8) Në kreun VI “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozim, prokurim me vlerë të vogël, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, bëhen disa shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 2 “Prokurim me vlerë të vogël”, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i) Pas fjalisë së fundit të shkronjës “c”, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rastin kur prokurimet me vlerë të vogël kryhen me mjete elektronike, anëtarët e

komisionit ftojnë të paktën tre operatorë ekonomikë, kur është e mundur, si dhe publikojnë ftesën për ofertë, për çdo të interesuar, në sistemin e prokurimit elektronik.

Kur ofertuesi fitues tërhiqet nga oferta e tij, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave që kanë mbetur.

Në çdo rast, procesi i përzgjedhjes së fituesit do të vazhdojë edhe me paraqitjen e një oferte të vlefshme.

Procedura e hapjes dhe e vlerësimit të ofertave do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.”.

ii) Fjalja e parë dhe fjalja e dytë e shkronjës “ç”, riformulohen si më poshtë vijon:

“Kjo procedurë, përveç rasteve të mësipërme, mund të përfshijë të gjitha prokurimet me vlerë të vogël dhe të paparashikueshme, si për shembull: ndryshimi i bravës, riparimi i pajisjeve të ndryshme, defekteve të vogla të automjeteve gjatë udhëtimit, si dhe prokurime të tjera të së njëjtës natyrë. Në të tilla raste emergjence ose ku prania e komisionit është e pamundur, prokurimet mund të kryhen edhe nga persona, që nuk janë anëtarë të komisionit.”.

b) Në shkronjën “ç” të pikës 3 “Shërbimet e konsulencës”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) Fjalja e parë e paragrafit të katërt riformulohet si më poshtë vijon:

“Njoftimi. Për të marrë deklaratat e shprehjes së interesit, autoriteti kontraktor bën njoftimin e kërkesës për shprehje interesi për çdo kontratë për shërbime konsulence në përputhje me nenin 38 të LPP-së, ku përcaktohen kriteret e përzgjedhjes.”.

ii) Pas nënparagrafit të pestë shtohet nënparagrafi i gjashtë me këtë përmbajtje:

“vi) Formularin e sigurimit të ofertës.”.

9. Në kreun VII “Kushtet e përgjithshme për zbatim”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fjalinë e parë të shkronjës “a” të pikës 1, fjalët “... duhet të pranohen të paktën 2 (dy) oferta të vlefshme ...” zëvendësohen me fjalët “... të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme ...”.

b) Në shkronjën “b” të pikës 2, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i) Fjalja e dytë riformulohet si më poshtë vijon:

“Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e grupit caktojnë, me prokurë, përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.”.

ii) Në fund të shkronjës “b” shtohet fjalja me këtë përmbajtje:

“Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.”.

c) Pas shkronjës “b” të pikës 3 “Kohëzgjatja e kontratës”, shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të përllogaritë fondin total dhe të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me të.”.

10. Në kreun VIII “Ekzekutimi i kontratës”, shkronja “a” e pikës 2 “Mbikëqyrja e kontratës”, riformulohet si më poshtë vijon:

“a) Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe/ose organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, mund të mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit dhe vendin e zbatimit, sipas legjislationit në fuqi apo sipas kërkesave, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të nenit 13 pika 3/ç të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga Agjencia e Prokurimit Publik përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga data e zgjidhjes së kontratës apo data e përfundimit të saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë.”.

11. Në kreun IX “Shqyrtimi i ankesave”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës “a” të pikës 1 shtohet shkronja “a.1” me këtë përmbajtje:



“a.1) Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 (tri) ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik në përputhje me pikën 6 të nenit 63 të LPP-së.”.

b) Fjala e parë e shkronjës “b”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Gjatë procedurës së prokurimit, ankesat kundër vendimeve të autoritetit kontraktor duhet të dorëzohen fillimisht pranë autoritetit kontraktor.”.

c) Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) Për procedurat e prokurimit për të cilat nuk bëhet njoftim publik sipas nenit 38 të LPP-së, nuk zbatohen dispozitat lidhur me procedurat e rishikimit administrativ.”.

12. Në kreun X “Sanksionet administrative dhe masat disiplinore”, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Mosrespektimi i rregullave të prokurimit, në përputhje me dispozitat e LPP-së, kur përbën kundërvajtje administrative dënohet me masë disiplinore ose me gjobë, si më poshtë vijon:

a) Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në nenin 4 të LPP-së, dënohet me gjobë 1 000 000 lekë;

b) Mospërmbushja e detyrimit, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 12 të LPP-së, dënohet me gjobë nga 15 000 deri në 30 000 lekë;

c) Mospërmbushja e detyrimit për formën e komunikimit, për shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit, të përcaktuar në nenin 21 të LPP-së, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

ç) Mospërmbushja e detyrimit, të parashikuar në nenin 23 të LPP-së, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë;

d) Mospërmbushja e detyrimit, të përcaktuar në nenin 25 të LPP-së, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

dh) Mospërmbushja e detyrimit, të përcaktuar në nenin 28 të LPP-së, dënohet me gjobë nga 20 000 deri në 1 000 000;

e) Mospërmbushja e detyrimit, të përcaktuar në nenin 38 të LPP-së, dënohet me gjobë nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë;

ë) Mospërmbushja e njërit prej detyrimeve, të përcaktuara në nenet 39, 40, 41 e 42 të LPP-së, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 300 000 lekë;

f) Mospërmbushja e detyrimeve, të përcaktuara në nenin 43 të LPP-së, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 500 000 lekë;

g) Mospërmbushja e detyrimit, të përcaktuar në nenin 53 të LPP-së, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 1 000 000 lekë;

gj) Mospërmbushja e detyrimit, të përcaktuar në nenin 56 të LPP-së, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë;

h) Mospërmbushja e detyrimit, të përcaktuar në nenin 63 dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 1 000 000 lekë;

i) Personat, që përpiqen të ndikojnë në vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, në kundërshtim me nenin 19/7 të LPP-së, dënohen me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.”.

b) Pika 3 riformulohet si më poshtë vijon:

“3. Në të gjitha rastet e mësipërme, kur personat përgjegjës nuk dënohen me gjobë dhe në çdo rast tjetër të shkeljes së dispozitave të LPP-së, kërkohet dhënia e masave disiplinore ndaj tyre. Në dhënien e masës administrative apo disiplinore duhet të mbahen parasysh rrethanat, pasoja dhe roli i zyrtarit në shkelje dhe, në çdo rast, zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.

Sanksionet administrative dhe masat disiplinore nuk përjashtojnë përgjegjësinë penale të personit përgjegjës për shkeljet.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 90, datë 6.2.2013

**PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2013, PËR AUTORITETIN
E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 117 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2013, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare, në shumën 273 300 000 (dyqind e shtatëdhjetë e tre milionë e treqind mijë) lekë, të ndarë sipas zërave, të paraqitur në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

**STRUKTURA E PROJEKTFONDIT TË SHPENZIMEVE PËR VITIN 2013 TË AUTORITETIT
TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Nr.	Emërtimi	Lekë
	Shpenzimet gjithsej:	273,300,000
1	Paga	75,500,000
2	Kontribut i sigurimeve shoqërore e shëndetësore	10,500,000
3	Materiale	5,800,000
4	Shërbime	48,000,000
5	Investime	133,500,000

VENDIM
Nr. 1, datë 7.2.2013

**PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE NË ZBATIM TË FONDIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 119, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve



VENDOSI:

1. Financimin në vlerën 1 677 288 969 (një miliard e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, pjesë e fondit të buxhetit të vitit 2013, për Fondin për Zhvillimin e Rajoneve, për infrastrukturën vendore, të ndarë si më poshtë vijon:

a) vlerën prej 299 803 126 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e tetëqind e tre mijë e njëqind e njëzet e gjashtë) lekësh, për likuidimin e projekteve të infrastrukturës rrugore, sipas listës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi;

b) vlerën prej 1 377 485 843 (një miliard e treqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet e tre) lekësh, për projekte në zbatim të infrastrukturës rrugore, sipas listës nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave të kryejë veprimet për bërjen efektive të fondeve.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Punëve Publike dhe Transportit	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Shkencës	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	anëtar;
Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit	anëtar;
Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	anëtar;
Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Kryetari i Bordit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Konferencës së Rektorëve	anëtar.

Lista nr.1. Projektet e infrastruktures vendore per likujdim

Nr.	Njesia e Qeverisjes Vendore	Emertimi i projektit	Vlera per likujdim
Qarku Berat			
1	Komuna Kozare	Rikonstruksion I Rruges Gege - Frasher	8,389,539
2	Komuna Kozare	Rikonstruksion I Rruges Gege - Frasher - kontrate shtese	19,000,000
3	Komuna Gjerbes	Rikonstruksioni I rruges Qender Gjerbes - Ura	4,460,264
4	Komuna Lumas	Ndertimi I zyrave te Komunes Lumas	6,136,671
5	Keshilli I qarkut Berat	KUL, Qyteti Berat	8,496,602
Qarku Diber			
6	KomunaZall - Dardhe	Ndertim I Ures "Tip Balley" mbi Lumin Drin	3,593,239
7	Komuna Ostren	Sistemim Asfaltim I qendres se fshatit Osten I Madh	4,419,821
8	Komuna Suc	Ndertimi I rruges Kurdari - Kap - Kurqe	1,793,082
Qarku Durres			
9	Komuna Ishem	Sistemim dhe Asfaltim rruge Fushe Gjericaj -Likmetaj (Likmetaj Bregdet)	11,137,833
Qarku Elbasan			
10	Bashkia Peqin	Rikonstruksion I Rruges " Klaudiana"	4,569,919
11	Komuna Hotolisht	Rikonstruksion I Rruges Auto Xhyre	12,173,857
12	Komuna Qender Librazhd	Rikonstruksion I Rruges Fshati Kuturman L= 4576 ml	7,835,236
13	Komuna Kodovjat	Sistemim asfaltim I qendres se Komunes Kodovjat	5,492,582
Qarku Fier			
14	Komuna Remas	Sistemim, Asfaltim I Rruges Karavasta e Re - Adriatik	30,798,428
Qarku Gjirokaster			
15	Komuna Luftinje	Rikonstruksion, Sistemim, Asfaltim I Rruges se Izvorit	6,675,735
16	Komuna Dropull I Poshtem	Rikonstruksion I Rruges se Fshatit Peshkepi e Poshtme dhe riveshje e aksit rrugor Kryqezim Grapsh - Gline	3,597,659
17	Komuna Petran	Sistemim, Asfaltim I Rruges se Fshatit Badelonje	13,039,191
18	Bashkia Kelcyre	Sistemim Lulishte Kelcyre	7,898,058
19	Komuna Qender Libohove	Rikonstruksion I Rruges Fshati Suhe - Stegopull	6,616,049
Qarku Korce			
20	Komuna Mollaj	Sistemim, Asfaltim Rruga + Kanalizimi I Ujrave te Zeza + Sistemim Perroi ne Fshatin Dvoran (Mollaj)	7,246,779
21	Komuna Voskop	Asfaltim Rruge Vincan - Vincan Larte	2,457,000
22	Komuna Proger	Sistemim asfaltim ndertim pusi ujesjellesi dhe KUZ Rakicke	9,584,867
Qarku Kukes			
23	Komuna Llugaj	Sistemim Asfaltim I rruges Llugaj - Sopot	21,790,213
Qarku Lezhe			
24	Komuna Zejmen	Asfaltim I Rruges Pllane Autostrade L = 2010 ml	6,497,629
Qarku Shkoder			
25	Komuna Gruemire	Sistemim, asfaltim rruga Hysaj	10,346,074



26	Komuna Rrethina	Sistemim, Asfaltim Rruga Shtoj I Ri - Grude e Re	5,644,392
27	Komuna Rrape	Rikonstruksion Rruge Auto Bicaj	11,577,915
Qarku Tirane			
28	Komuna Golem	Rruge Hyrese e Masterplanit te Zones Turistike Mali I Robit - Plazh	9,480,498
29	Komuna Paskuqan	Ndertim I Rruges mbi Kanalin kryesor te Ujrave te bardha dhe te Zeza Paskuqan 2	16,097,962
Qarku Vlore			
30	Komuna Ksamil	Ndertim , asfaltim I rruges Nr.17/1	5,703,799
31	Komuna Mesopotam	Rikonstruksion I Rruges Livine	14,936,705
32	Keshilli i Qarkut Vlore	Rikonstruksioni I rruges se Varrezave te Qytetit Vlore	8,478,288
33	Keshilli i Qarkut Vlore	Rikonstruksioni I rruges se Varrezave te Qytetit Vlore - kontrate shtese	3,837,240
TOTALI			299,803,126

Lista nr.2. Projektet e infrastruktures vendore te miratuara ne vitin 2012

Nr.	Njesia e Qeverisjes Vendore	Emertimi i projektit	Vlera për financim 2013
Qarkut Berat			
1	Keshilli i Qarkut Berat	Rikonstruksioni I rruges Veterik - Guri I Bardhe	24,213,708
2	Komuna Lumas	Rikonstruksion i rruges Qender - Lumas, Shaipllar - Katundas, (seg. 1+2)	14,561,465
3	Komuna Cukalat	Rikonstruksion i rruges ' Donofros - Velmish '	24,669,398
4	Komuna Perondi	Rikonstruksion i rruges Magjate - Goraj - Velagosht (Faza e Pare)	15,437,640
5	Komuna Kozare	Sistemim, Asfaltim i rruges Polovine - Gege	35,866,086
6	Komuna Bogove	Rikonstruksion i rruges Dobrush - Perparim	15,659,164
7	Bashkia Corovode	Ndertimi i unazes jug-lindore te Qytetit te Corovodes (faza I)	13,965,877
8	Komuna Qender Skrapar	Sistemim, Asfaltim i rruges Verzhazhe	9,912,774
9	Komuna Vendreshe	Sistemim dhe Asfaltim I rruges Lisi I Buzuqit - Vendreshe	3,876,032
Qarku Diber			
10	Komuna Zerqan	Rruga Zerqan - Tre cezmat (Faza I)	17,475,172
11	Komuna Maqellare	Sistemim Asfaltim Rruga e Fshatit Katundi I Vogel	1,049,205
12	Bashkia Peshkopi	Sistemim, Asfaltim i rruges poshte gjykates	5,960,709
13	Komuna Kastriot	Sistemim, Asfaltim Rruga Borovjan - Deshat, Degezimi Vajnice	12,438,136
14	Komuna Macukull	Ndertim I Rruges se Fshatit Shelli (lidhja e fshatit Shelli me Shqefen dhe Macukull)	8,155,228
15	Komuna Komsj	Sistemim, Asfaltim i rruges se Fshatit Pjez	6,972,223
16	Bashkia Klos	Sistemim Asfaltim I rrugeve te qytetit Klos (Loti I Pare)	4,983,449
17	Komuna Xiber	Rikonstruksioni I rruges Xiber Hane – Kete	1,004,742
18	Bashkia Klos	Sistemim, Asfaltim I rruges se Fshatit Dars	6,499,182
Qarku Durres			
19	Komuna Katundi i Ri	Rikonstruksioni I rruges Katundi I Ri -Lapidar- Qerret (faza I)	11,020,246
20	Bashkia Manez	(1) Rikonstruksion i rruges ne lagjet 'Hushe dhe Deda ', Fshati Kamas; (2) rikonstruksioni i rruges Rikonstruksioni I rrugeve ne lagjet Hoxha dhe Fortuzi te fshatit Shkalle (faza I)	6,792,556
21	Bashkia Shijak	Rikonstruksioni I rruges 8 Marsi dhe Degezimet	5,886,562
22	Bashkia Kruje	Rikonstruksioni I rruges Lagjia Pengile te qytetit Kruje	19,265,448
23	Komuna Bubq	Rikonstruksion i rruges Ura e Gjoles - Kisha Bilaj	15,420,827
24	Keshilli I Qarkut Durres	Rikonstruksion I rruges nacionale Qender-Manskuri	10,769,078
25	Keshilli I Qarkut Durres	Rikonstruksion I rruges tunel I Rrashbullit - varrezat e reja	7,367,235
26	Komuna Xhafzotaj	Sistemim, Asfaltim i rrugeve te Fshatrave Borake dhe Koxhase (faza I)	9,175,085
Qarku Elbasan			
27	Bashkia Elbasan	Rikonstruksion dhe Asfaltim I Rruges "Krate e Madhe " (Faza e Pare)	20,193,368
28	Bashkia Cerrik	Ndertim trotuari ne veri te Rruges Nacionale Cerrik - Elbasan, lagjia nr.2	6,933,224



29	Komuna Grekan	Rikonstruksion dhe Asfaltim I rruges Deshiran - Gjolene	16,142,664
30	Komuna Bradashesh	Sistemim asfaltim Hotel Europa, Lagjia Havaleas dhe nga Kryeqezimi I ish NMMT uzines ne 12.	16,502,926
31	Komuna Shirgjan	Rikonstruksioni I rruges Urbane Kryeqezimi I rruges automobilistike Elbasan - Cerrik, Fshati Bujqes	12,141,290
32	Komuna Kodovjat	Rikonstruksion i rrugeve te Fshatit Bersnik	5,820,892
33	Komuna Pishaj	Sistemim, Asfaltim rruga nga lagjia Gramsh - Kocaj - Fshati Gramsh - Vine (faza I)	17,765,287
34	Bashkia Prrenjas	Unaza Prrenjas Fshat - Katiel	24,312,108
35	Komuna Shushice	Sistemim, Asfaltim, ndricim i qendres Shushice	1,989,789
36	Komuna Orenje	Ndertim i Ures tip bally per fshatrat Gurakuq, Rinas, Ballgjin	1,237,185
37	Komuna Stravaj	Sistemim, Asfaltim, Trotuare, Ndririm rruga e Mesit dhe e Gabines	19,242,924
38	Komuna Hotolisht	Rikonstruksion i rruges automobilistike te Fshatit Dardhe	17,349,779
39	Bashkia Librazhd	Sistemim, Asfaltim rruga Sherbeniku dhe rruga e Mokres	10,995,291
40	Komuna Pajove	Sistemim asfaltim I rrugeve te fshatit Lazaren	9,821,357
41	Komuna Karine	Rikonstruksion i rruges Qender Karine - Vorrezat Drangajt	3,826,378
42	Komuna Klos	Rruga "Unaza e Klosit"	10,898,724
43	Komuna Gjocaj	Rikonstruksion i Rruges Celepias - Kurtaj - Bregas	8,831,862
44	Bashkia Belsh	Rikonstruksion dhe Asfaltim I rrugeve Kryesore te Qytetit te Belshit (Faza e Pare)	16,717,424
Qarku Fier			
45	Bashkia Roskovec	Ndertim i Unazes se Re ne Qytetin e Roskovecit	21,809,976
46	Komuna Kuman	Rikonstruksioni I Rruges Kuman - Luar - Vidhishte (lot I)	20,827,983
47	Komuna Topoje	Rikonstruksion i rruges Topoje - Sheq Marine - Seman	21,134,773
48	Komuna Hysgjokaj	Sistemim Asfaltim i rruges Hysgjokaj-Ballagat	12,713,094
49	Komuna Bubullime	Rikonstruksioni I rruges Superstrate - Bubullime- Imesht	13,956,000
50	Komuna Fiershegan	Sistemim asfaltim i unazes Fier Shegan Kocaj	5,332,391
51	Komuna Terbuf	Rruga Cerme Proshk	4,904,028
52	Komuna Kute	Ndertimi i rruges Fratar - Drizar	2,640,000
53	Komuna Aranitas	Rikonstruksion I rruges Qafa e Kashit- Usoje - Kalenje	14,508,499
54	Komuna Qender Mallakaster	Rikonstruksion i rruges Drenove - Fushe- Drenove Mal	21,562,331
55	Komuna Terbuf	Rruga e fshatit Shenepremte	12,149,507
Qarku Gjirokaster			
56	Komuna Cepo	Urat automobilistike te poshtme dhe te sipërme ne Fshatin Zhulat mbi lumin e Zhulatit	1,836,041
57	Komuna Suke	Sistemim, Asfaltim i rruges se Fshatit Podgoran	8,548,690
58	Komuna Luftinje	Rikonstruksion i rruges 'Sektori III - Zhapokike - Qender '	1,709,784
59	Komuna Buz	Rikonstruksion i rruges " Qafa e Kicokut - Shales "	1,999,947
60	Komuna Krahes	Asfaltim rruge- Rruge Nacionale - Lagjia Bregadove - Buckaj	996,600
61	Bashkia Libohove	Rikonstruksion I rruges se Lagjes Marine dhe Lagjes Teqe Mehalle	1,134,703
62	Komuna Picar	Rikonstruksion I rruges Picar-Kolonje-Golem (faza e pare)	11,333,145

Qarku Korce			
63	Komuna Miras	Asfaltim i rruges Zecisht - Fitore	9,235,430
64	Keshilli Qarkut Korce	Rikonstruksion I Rruges Kryqezimi Poloske - Perparimaj - Cipan	27,636,144
65	Komuna Voskopoje	1) Ndertim i rruges Rilindja Voskopoje me kalldrem me gure te latuar ne Voskopoje dhe 2) Ndertim i rruges Gjergj Simoni me kalldrem me gure te latuar	8,572,199
66	Komuna Vithkuq	Sistemim, Asfaltim i rruges kryqezimi Vithkuq - Lubonje	8,813,729
67	Komuna Qender Leskovik	Sistemim, Asfaltim i rruges auto Leskovik - Fshati Pobicke - Fshati Radat (faza e pare)	10,000,000
68	Komuna Clirim	Rikonstruksion i rruges Qafezeze - Clirim	9,107,427
69	Komuna Hudenisht	Sistemim asfaltim rruga lart fshati Memlisht	10,019,974
70	Komuna Velcan	Sistemim Asfaltim Qafa e Losnikut - Velcan	28,240,080
71	Komuna Bucimas	Rikonstruksion i rruges hyrese dhe sheshit te Fshatit Tushemisht	9,602,526
72	Komuna Cerrave	Sistemim, Asfaltim Rruge Lagje Fshati Petrushe	4,455,826
Qarku Kukes			
73	Bashkia Bajram Curri	Sistemim asfaltim I rrugeve te qytetit Bajram Curri - Bulevardi i qytetit faza I	13,773,542
74	Bashkia Kukes	Rikonstruksion i rruges 6 kateshe - Xhami	3,511,030
75	Bashkia Kukes	Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges 'Gjeologji - Obelisk'	3,484,154
76	Bashkia Kukes	Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges Banesa M. Cena- Ujesjelles, Lagje 3 Kukes	3,543,470
77	Komuna Shtiqen	Asfaltim i rruges Shtiqen - Uzhine	9,044,483
78	Komuna Bytyc	Sistemim, Asfaltim i rruges Pac - Berishe (Pac - Qafe Nevadi), loti I	15,655,455
79	Komuna Bujan	Rikonstruksioni I rruges Qender Komune - Bllate	8,484,555
80	Bashkia Bajram Curri	Rruget e Qytetit Bajram Curri, lagjia Partizani (Unaza) faza I	11,555,739
81	Komuna Bujan	Zyrat e Komunes Bujan	6,071,745
82	Komuna Fierze	Sistemim asfaltim I rruges Kodra e Xanit - Balle fushe	12,787,188
Qarku Lezhe			
83	Komuna Fushe - Kuqe	Sistemim, asfaltim i rruges se varrezave Gurez	10,937,237
84	Komuna Milot	Rikonstruksion I Rruges Nacionale Skuraj	14,584,906
85	Komuna Blinisht	Asfaltim i rruges kryesore te Fshatit Fishte (Faza e pare)	9,775,862
86	Komuna Selite	Rruge auto Kthelle e Eper - Varreza	7,776,627
87	Komuna Kthelle	Sistemim, Asfaltim i rruges Perlat - Qender - Troje	7,257,177
88	Komuna Shengjin	Sistemim, asfaltim I shetitores Wilson (faza I)	13,514,400
Qarku Shkoder			
89	Komuna Kelmend	Ndertim i rruges Muriq - Qender Vukel	8,160,908
90	Bashkia Shkoder	Riveshje asfaltim dhe ndertim trotuari Rruge Industriale I	13,405,272
91	Komuna Qender - Malesi e Madhe	Rehabilitim i rruges Hasaj (vorreza - liqeni i Shkodres)	4,600,633
92	Komuna Shkrel	Sistemim, Asfaltim i rruges Cek Dedaj	9,992,451
93	Bashkia Puke	Rikonstruksioni I aksit kryesor te Qytetit Puke (Faza I)	14,457,308



94	Komuna Qerret	Rikonstruksion, Sistemim, Asfaltim rruga auto Korthpule - Tejkoder - Vrrith	9,606,380
95	Komuna Gjegjan	Hapje rruge Auto, Qendra e Komunes Gjegjan - Ura Dom	2,037,761
96	Bashkia Fushe Arrez	Sistemim Asfaltim I rrugët e fshatit Fushe Arrez, lagje Shpoz, Marinaj, Dedej	12,847,857
97	Komuna Shosh	Rehabilitim i rruges se Fshatit Palaj	5,626,123
98	Komuna Postribë	Sistemim, Asfaltim rruga Domen (Faza I)	10,069,335
99	Komuna Bushat	Sistemim, Asfaltim i rruges Rranxa - Mundija - Mali i Jushit - Rruge Nacionale	20,518,860
100	Komuna Kastrat	Rehabilitim i rruges ' Jaran - Gradec - Marsheje - Rezervuarë '	11,584,960
101	Komuna Vig Mnele	Ndertimi i urave te Vigut (Fushe Vig; kaster Vig)	9,576,427
102	Bashkia Koplik	Plani I rruges dhe Ujesjellesi Qender Koplik Rrethrotullimi Superstrate - Rruga e Boges	16,817,606
Qarku Tirane			
103	Bashkia Tirane	Degezimi rruga' Budi - Vellezerit Kondi 3 (Rikonstruksioni i rruges Dajti)	10,000,000
104	Bashkia Tirane	Rikonstruksion i rruges se Qelqit	20,000,000
105	Nj.Bashkiakë nr.11	Tirane -Fushe Kruje vazhdon nga ish fabrika e tullave, Reparti Ushtarak 3030 dhe del para shkolles 9-vjecare Isa Boletini	22,043,734
106	Bashkia Tirane	Ndertim I Kanalit dhe I rruges nga rrg. " Dalip Topi " deri ne rrg. " Marie Kraja " (rrg. Kokonozeve)	20,000,000
107	Bashkia Tirane	Ndertim bulevardit Petro Nini Luarasi	20,000,000
108	Bashkia Tirane	Ndertim I rrugeve se Kosovareve (Faza I)	20,000,000
109	Bashkia Tirane	Ndertim I rruges Brigada VIII-te	10,000,000
110	Bashkia Tirane	Ndertim I rruges Pjeter Bogdani	20,000,000
111	Bashkia Vore	Sistemim, Asfaltim I rruges Marqinet - Qendra e Mbylljes per te Huajt, Karreq	2,891,484
112	Keshilli i Qarkut Tirane	Rikonstruksioni rruges Pellumbas Klllojke	16,322,993
113	Komuna Synej	Rruga Byk - Lagja Nerjak dhe Rruga Muc - Daut - Hallull - Metant	9,192,038
114	Bashkia Rrogozhine	Rikonstruksion i rrugeve te brendshme ne Rrogozhine (Faza I)	1,505,964
115	Komuna Farke	Rikonstruksion (Asfaltim) i rruges Shkolla Farke - Kryqezim Helikopterat - Lagjia e re e liqenit	11,713,652
Qarku Vlore			
116	Bashkia Delvine	Rikonstruksion i rruges Delvine - Rusan	1,547,915
117	Komuna Brataj	Rruge te brendshme Lepenice	760,000
118	Komuna Sevaster	Sistemim, Asfaltim i rruges Ploc - Amonic, Fshati Amonic	14,691,778
119	Bashkia Himare	Rikonstruksion rruge te brendshme , ujesjellesi, KUZ,KUB, ndricim rrugor, tefoni, lagjia Stefanel	20,230,777
120	Komuna Novosele	Rikonstruksion i rruges Hidrovor Akerni (faza II)	12,025,704
121	Komuna Markat	Rikonstruksion, Sistemim, Asfaltim i rruges nacionale Janjar - Ninat - Markat	9,599,826
TOTALI			1,377,485,843

URDHËR
Nr. 87, datë 1.2.2013

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE
VEPRIMEVE QË DUHET TË KRYEJNË NËPUNËSIT E SHËRBIMIT TË GJENDJES
CIVILE NË BASHKI/NJËSI BASHKIAKE/KOMUNA, PËR NDRYSHIMIN E
VENDBANIMIT/ADRESËS SË SHTETASVE”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4 të nenit 15, të pikës 3 të nenit 18, të germës “a” dhe “b” të nenit 65, të ligjit nr. 10 129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” dhe të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1243, datë 11.12. 2009 “Për përcaktimin e dokumenteve, që duhet të paraqesin shtetasit, e të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile, në bashki/njësi bashkiake/komuna, dhe institucionet shtetërore, të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe veprimeve që duhet të kryejnë nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve”, të hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka

RREGULLORE
**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE VEPRIMEVE, QË DUHET TË KRYEJNË
NËPUNËSIT E SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI/NJËSI
BASHKIAKE/KOMUNA, PËR NDRYSHIMIN E VENDBANIMIT /ADRESËS SË SHTETASVE**

I. Rregullat dhe veprimet kur shtetasit kërkojnë ndryshimin e vendbanimit/adresës

1. Shtetasit, të cilët kërkojnë të ndryshojnë vendbanimin/adresën dhe përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, institucioneve të posaçme, duhet të paraqesin pranë zyrës së gjendjes civile, në territorin e së cilës është vendbanimi i ri, dokumentacionin përkatës, të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1243, datë 11.12.2009 “Për përcaktimin e dokumenteve që duhet të paraqesin shtetasit, e të procedurave, që duhet të kryejnë zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në institucionet shtetërore, të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve”.
2. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, pasi shqyrton dhe verifikon dokumentacionin e paraqitur nga shtetasi/institucioni, kërkon në RKGJC, të dhënat e shtetasit. Nëpunësi, pasi identifikon të dhënat e shtetasit që ka bërë kërkesën, printon në formatin A4, përbërjen familjare të tij, duke i kërkuar shtetasit konfirmimin për saktësinë e të dhënave të përbërjes së tij familjare. Shtetasi pasi verifikon saktësinë e të dhënave të familjes së tij, nënshkruan këtë formular. Ky formular i bashkëlidhet dokumentacionit që ka paraqitur shtetasi.



3. Për shtetasit, të cilët kërkojnë ndryshimin e vendbanimit/adresës, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, duhet të ndjekë procedurat e mëposhtme për të gjithë pjesëtarët e familjes:

a) Shkruan të dhënat e personit që do t'i ndryshojë vendbanimin dhe klikon në butonin “kërko person”, si në figurën 1 (shigjeta a);

b) Përzgjedh personin, të cilit do t'i ndryshojë vendbanimin, si në figurën 1 (shigjeta b);

c) Më pas, klikon në rubrikën “ndrysho vendbanimin” si në figurën 1 (shigjeta c);

ZGJC aktuale Berat ZGJC 1 **NCR Assist Germa të vecanta** **Mjedis testimi** **SU.ZM** NCR-

Përdoruesi aktual: rudina.brari@moi.gov.al

Procesi i regjistrimit

- Kërko person
- Krijë person
- Ndrysho person
- (Jo) bllokim personi
- Ndrysho emrin
- Ndrysho venbanimin
- Cregjistro vendbanimi
- Korigjo venbanimin
- Familja
- Printo certifikatën
- Printo ndryshimin e pe
- Dokumentet e lëshuar

Kërko person **Personat e gjetur** Të dhëna personale Dokumente identiteti Kombësia Bllokim i informacionit Babai Nëna Të d

Personi u gjet. 70100 10:33 6840100

Numri personal: F00909060F

Emri/mbiemri	Datëlindja/vendlindja	Arsyeja e regjistrimit	I vlefshëm q prej
Luan Meta	09.09.1950/Kovashice,Diber	Migrim	09.09.1950

Lloji i vendb.	Komuna	Rruga	Kodi postar	Rrethi	Arsyeja e regjistrimit	Regjistruar nga
K	Kovashice		0000	Panijohur	Migrim	09.09.1950

Fig. nr. 1

ç) Me shfaqjen e pamjes, si në figurën nr. 2, përzgjedh, njërën nga 4 arsyet e ndryshimit të vendbanimit, sipas rastit që do të paraqitet;

ZGJC aktuale Berat ZGJC 1 **NCR Assist Germa të vecanta** **Mjedis testimi** **SU.ZM** NCR-Server Ve

Përdoruesi aktual: rudina.brari@moi.gov.al

Procesi i regjistrimit

- Kërko person
- Krijë person
- Ndrysho person
- (Jo) bllokim personi
- Ndrysho emrin
- Ndrysho venbanimin**
- Cregjistro vendbanimi
- Korigjo venbanimin
- Familja
- Printo certifikatën
- Printo ndryshimin e pe
- Dokumentet e lëshuar
- Printo certifikatën hist

Regjistro vendbanimin

U krye

Pastro Ruaj

Regjistro vend

Të dhëna personale

Numri personal F00909060F

Emri/mbiemri Luan Meta

Datëlindja/vendlindja 09.09.1950/Kovashice,Diber

Ndryshuar më 12.11.2008 20:43

Punonjësi i ZGJC Migration

organizata 000066

Arsyeja Zgjidh...

Përshkrimi Zgjidh...

Lloji i vendb.

Sipas kërkesës së të interesuarit

Sipas vendimit të gjykatës

Sipas shkresës së institucioneve

Sipas aktit të martesës

Fig. nr. 2

Pasi ka përzgjedhur arsyen “Sipas kërkesës së të interesuarit”, plotëson rubrikën e përshkrimit, duke vendosur numrin e protokollit dhe datën e kërkesës së shtetasit, si dhe zyrën e gjendjes civile të mëparshme (shiko figurën 3).

Fig. nr. 3

Pasi plotësohen rubrikat e mësipërme, përzgjedh llojin e vendbanimit (shiko figurën 4).

Fig. nr. 4

d) Pasi përzgjedh llojin e vendbanimit sipas tabelës, si në fig. nr. 4, plotëson të dhënat e adresës si më poshtë, si në figurën nr. 5:

- Rrethi;
- Bashkia/komuna;
- Një nga emrat e fshatrave që përbëjnë bashkinë/komunën, kur ka;
- Emrin e rrugës;
- Numrin e ndërtesës (0000);
- Numrin e hyrjes (00);
- Numrin e apartamentit (000);
- Kodin postar (kod katërshifror).



Adresa kryesore/e përkohshme		Adresa jashtë vendit	
Rrethi	Berat	Rrethi	
Bashkia/Komuna	Otllak	Bashkia/Komuna	
Vendi	Lapardha 1	Vendi	
Rruga	12	Shteti	Zgjidh...
Numri i ndërtesës	2	Emri i firmës 1	
Hyrja	1	Emri i firmës 2	
Numri i banesës, apt	12	Personi i kontaktit	
Kodi postar	5010	Kutia postare	
Regjistruar nga		Numri i telefonit	2226802
Regjistruar përkohësisht deri më		Numri i celularit	0694109108
Qeradhenesi			

Të plotësohen të gjitha rubrikat

Të plotësohet numri tel.

Fig. nr. 5

Sqarim. Për rubrikat që nuk ka informacion, si për: numri i ndërtesës, numri i hyrjes dhe numri i apartamentit, do të plotësohen deri në marrjen e këtij informacioni, me aq zero sa janë në krah të rubrikës sipas pikës “d”.

dh) Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, pasi plotëson rubrikat e mësipërme të adresës, klikon në butonin “**ruaj**” dhe do t’i shfaqet mesazhi, si në figurën nr. 6.

Mirësevini	
Informacion	Vendqendrimi u krijua me sukses. Korigjoni dhe numrin e votimit (numri personal: 'E90301147C')! 70200 15:00 684010000002016

Fig. nr. 6

Vendbanimi i mëparshëm mbetet automatikisht në historikun e personit.

4. Pasi të jenë kryer veprimet për ndryshimin e vendbanimit të personit, duhet të ndryshohet detyrimisht edhe kodi 10 shifror zgjedhor, numri i votimit, veprim i cili kryhet si më poshtë:

a) Fillon me procesin e regjistrimit duke kërkuar dhe përzgjedhur personin, të cilit do t’i bëjmë ndryshimin. Klikon te rrethi në krah të emrit dhe më pas shkon te rubrika “ndrysho person”, sipas figurës nr. 7.

Procesi i regjistrimit		Kërko person		Personat e gjetur		Të dhëna personale		Dokumente identiteti		Kombësia		Bllokim i inform	
Mirësevini		Informacion Personi u gjet.											
Kërko person		1 - 10 (35)											
Krijë person		Numri i identitetit: F00909060F											
Ndrysho person		Emri/mbiemri Datëlindja/vendlindja											
Ndrysho emrin		Luan Meta 09.09.1950/Kovashice,Dibe											
Regjistro vendbanimin		Lloji i vendbanimit Rruga Kodi postar Rrethi											
Cregjistro vendbanimin		K Kovashice 0000 Panjohur											
Ndrysho vendbanimin													
Familja													
Printo certifikatën													
Printo ndryshimin e pe													

a

b

c

Fig. nr. 7

b) Pasi klikon butonin “ndrysho person”, nga tabela do të zgjidhet opsioni “ndrysho numrin e votimit”, sipas fig. nr. 8.

The screenshot shows the QBZ system interface. On the left, there is a sidebar menu with options like 'Kërko person', 'Krijo person', 'Ndrysho person', 'Ndrysho emrin', 'Regjistro vendbanimin', 'Cregjistro vendbanimin', 'Ndrysho vendbanimin', 'Familja', 'Printo certifikatën', 'Printo ndryshimin e pe', 'Dokumentet e lëshuara', 'Printo certifikatën histo', and 'Zgjedhje'. The main area shows a form with fields for 'Arsyeja' (Reason), 'Përshkrimi' (Description), 'Data e ndryshimit' (Date of change), 'Numri i identitetit' (Identity number), 'Emri' (Name), 'Mbiemri' (Surname), 'Mbiemri para martesës' (Surname before marriage), and 'Ddatëlindja' (Date of birth). The 'Arsyeja' dropdown menu is open, showing options: 'Zgjidh...', 'Ndrysho person', 'Korrigjo sipas ZGJC', 'Vdekje', 'Ndrysho bllokimin e informacioni', 'Ndrysho dokumentin e identifikimit', 'Ndrysho numrin e votimit' (highlighted with a blue arrow), 'Ndrysho të dhënat e prindërve', and 'Arsye tjetër'.

Fig. nr. 8

d) Pas përzgjedhjes së opsionit “ndrysho numrin e votimit”, shfaqen të dhënat sipas figurës nr. 9, në të cilën plotëson të dhënat për katër rubrikat e para, të cilat përfaqësojnë numrin e ri të votimit, si më poshtë:

- Kodi i ZGJC-së;
- Qendra e votimit;
- Fraksioni i qendrës së votimit;
- Kodi i ndërtesës.

The screenshot shows the 'Numri i votimit' (Voting number) form. It contains the following fields and values:

Numri i votimit	
Kodi i ZGJC	000 407
Qendra e votimit	2197
Fraksioni i qendrës së votimit	0
Kodi i ndërtesës	182
Kodi i ZGJC 2	
Qendra e votimit 2	
Fraksioni i qendrës së votimit 2	
Kodi i ndërtesës 2	

Fig. nr. 9

Pas kryerjes së këtyre veprimeve, procesi përfundon duke klikuar në butonin “ruaj”.

5. Veprimet e ndjekura për korrigjimin e numrit të votimit, të përshkruara në pikën 4, do të ndiqen edhe për rastet, kur shtetasi ndryshon vendbanimin si pasojë e lidhjes së martesës.

II. Rregullat dhe veprimet kur ndryshimi i vendbanimit/adresës kërkohet nga institucionet shtetërore të posaçme

6. Ndryshimi i vendbanimit/adresës për shtetasit në institucionet e Forcave të Armatosura, të vuajtjes së dënimit, në institucionet mjekësore të kurimit afatgjatë dhe institucionet arsimore, kryhet pasi nëpunësi i zyrës së gjendjes civile merr dokumentacionin nga institucioni përkatës, sipas pikës 1 të kësaj rregulloreje.

7. Për shtetasit që përfshihen në pikën 6 të kësaj rregulloreje, procedura e ndryshimit të vendbanimit/adresës fillon duke ndjekur të gjitha hapat e parashikuar në gjerat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 3 të kësaj rregulloreje dhe vazhdon si më poshtë:



a) Me shfaqjen e pamjes, si në figurën nr. 10, për zgjedh tek rubrika arsyje, opsionin “sipas shkresës së institucioneve” dhe të përshkrimi vendoset numri i protokollit dhe data e shkresës së institucionit përkatës (shiko figurën 10).

Fig. nr. 10

Pasi plotëson rubrikat e mësipërme, zgjedh llojin e vendbanimit: “vendqëndrimi i përkohshëm”, duke ndryshuar vetëm adresën e personit, e cila do të jetë, adresa e institucionit përkatës.

Fig. nr. 11

Këta shtetas nuk do të ndahen nga familja e tyre për këtë shkak. Gjendja e tyre familjare do të jetë e njëjtë, ajo do të ndryshojë vetëm në rast se vetë i interesuari, kërkon të ndahet nga familja, gjë e cila do të bëhet sipas procedurës së përcaktuar për këtë qëllim. Në rast lëshimi të certifikatës familjare, shtetasi do të figurojë në përbërjen familjare të tij.

a) Ky proces fillon me klikimin e butonit “procesi i regjistrimit”. Pasi kërkon dhe për zgjedh personin, për të cilin u krye ndryshimi i vendqëndrimit, klikon tek rrethi në krah të emrit dhe kalon në rubrikën “ndrysho person”, sipas figurës nr. 12.

Emri/mbiemri	Datëlindja/vendlindja	Arsyeja e regjistrimit	I vlefshëm që prej	I vlefshëm deri më
Luan Meta	09.09.1950/Kovashice, Diber	Migrim	09.09.1950	

Fig. nr 12

b) Pasi klikon në butonin “ndrysho person” nga tabela, përzgjedh opsionin “ndrysho numrin e votimit”, sipas fig. nr. 13.



Fig. nr. 13

c) Më pas përzgjedh butonin “ndrysho numrin e votimit”, ku do të shfaqen të dhënat sipas figurës nr. 14, në të cilën plotësohen/korrigjohen të dhënat për katër rubrikat e fundit.

Në këtë formë plotësohen të dhënat, sipas figurës nr. 14 për:

- Kodin e ZGJC 2;
- Qendrën e votimit 2;
- Fraksionin e qendrës së votimit 2;
- Kodin e ndërtesës 2.

Numri i votimit	
Kodi i ZGJC	000 092
Qendra e votimit	2339
Fraksioni i qendrës së votimit	0
Kodi i ndërtesës	098
Kodi i ZGJC 2	000 178
Qendra e votimit 2	0127
Fraksioni i qendrës së votimit 2	0
Kodi i ndërtesës 2	222

Fig. nr. 14

9. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, procesi përfundon duke klikuar në butonin “ruaj”.

10. Kur këta shtetas largohen nga këto institucione, zyra e gjendjes civile do të kryejë veprimet pasi të ketë marrë nga institucioni listën e shtetasve që janë larguar. Në këtë rast, nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile do të kryejë çregjistrimin e “vendqëndrimit të përkohshëm”, duke e kthyer shtetasin në vendbanimin/adresën e tij kryesore të mëparshme.

11. Afati i ruajtjes në sistem, i numrit të dytë të votimit do të jetë deri në përfundimin e periudhës së qëndrimit të shtetasve në këto institucione. Për të fshirë numrin e dytë të votimit duhet klikuar në kutinë “fshij numrin e dytë të votimit” dhe më pas klikon “ruaj”, si në figurën nr. 15.



+

 Akti i vdekjes

+

 Akti i martesës

+

 Pastrimi i të dhënave

+

 Parametrat

Numrat e HELPDESK

Cel: 069 41 30 740

Cel: 069 41 30 741

Numri i votimit

Kodi i ZGJC 000 376

Qendra e votimit 1788

Fraksioni i qendrës së votimit 0

Kodi i ndërtesës 017

Kodi i ZGJC 2 000 007

Qendra e votimit 2 1234

Fraksioni i qendrës së votimit 2 0

Kodi i ndërtesës 2 012

Fshij numrin e dytë te votimit ☐

Fig. nr. 15

12. Për rastet e ndryshimit të vendbanimit për shtetasit, me kujdestari, do të zbatohet procedura si më poshtë:

Në këtë rast, zyra e gjendjes civile duhet të administrojë dokumentacionin, që provon kujdestarinë mbi shtetasin (vendimin e gjykatës) dhe më pas fillon veprimet në RKGJC.

Rasti i një fëmije të mitur fillon me kërkimin e tij në RKGJC dhe më pas e përzgjedh atë, si në figurën nr. 16.

ZGJC aktuale Berat ZGJC 1

NCR Assist

Germa të vecanta

Mjedis testimi

SU.ZMR

NCR-Server Version:

Përdoruesi aktual: rudina.brari@moi.gov.al

Procesi i regjistrimit

Kërko person

Krijo person

Ndrysho person

(Jo) bllokim personi

Ndrysho emrin

Ndrysho vendbanimin

Cregjistro vendbanimin

Korigjio vendbanimin

Familja

Printo certifikatën

Printo ndryshimin e per

Dokumentet e lëshuara

Kërko person

Personat e gjetur

Të dhëna personale

Dokumente identiteti

Kombësia

Blokim i informacionit

Babai

Nëna

Të dhëna mbi vendbanimin

U krye

1 (1)

Kërko person: K11119089J

Emri/mbiemri	Datëlindja/vendlindja	Arsyeja e regjistrimit	I vlefshëm që prej	I vlefshëm më
Xhuljano Stafa	19.11.2001/kavala greqi	Ndryshim i nr.te votimit	25.05.2009	
Xhuljano Stafa	19.11.2001/kavala greqi	Arsye tjetër	25.05.2009	25.05.2009

Lloji i vendb.	Bashkia/Komuna	Rruga	Kodi postar	Rrethi	Arsyeja e regjistrimit	Regjistruar nga	Regjistruar më
K	Peqin	0 0 0 0	0000	Peqin	Ndrysho venbanimin	25.05.2009	

Fig. nr. 16

Pasi përzgjedh shtetasin që do t'i ndryshojë vendbanimin, shkon tek rubrika “arsye”, ku përzgjedh arsyen: “Sipas vendimit të gjykatës” si në fig nr. 17.

Fig. nr. 17

Pasi përzgjedh arsyen , në rubrikën e përshkrimit do të bëhen shënimet:

“Vendim nr. ... , datë , i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ... ”, caktohet kujdestar i fëmijës....., emër, mbiemër”.

Në këtë rast, fëmijës nuk i bëhet ndarje nga trangu, por i ndryshohet vetëm vendbanimi, ku si adresë i vendoset ajo e kujdestarit. Si në figurën nr. 18

Fig. nr. 18

Pasi kryen veprimet e cituara më sipër, kërkon edhe një herë personin për të verifikuar nëse janë pasqyruar të gjitha veprimet e kryera. Pasi sigurohet se procedura është kryer, klikon në rubrikat “personi” dhe “vendbanimi” si në figurën nr. 19.



(Jo) bllokimi personi 1 - 1 (1) << < > >>

Ndrysho emrin

Ndrysho venbanimin

Cregjistro vendbanimin

Korigjo venbanimin

Familja

Printo certifikatën

Printo ndryshimin e per

Dokumentet e lëshuara

Printo certifikatën histo

Zgjedhje

Dëgjuesimi nga zgjedh

Numri personal: K11119089J

Emri/mbiemri	Datëlindja/vendlindja	Arsyeja e regjistrimit	I vlefshëm që prej	I vlefshëm më
Xhuljano Stafa	19.11.2001/kavala greqi	Arsye tjetër	25.05.2009	

Lloji i vendb.	Bashkia/Komuna	Rruga	Kodi postar	Rrethi	Arsyeja e regjistrimit	Regjistruar nga	Regjistruar më
	Tirane	"Mihal Grameno" 12 1 0	0000	Tiranë	Sipas vendimit të gjykatës	14.11.2012	
K	Peqin	0 0 0 0	0000	Peqin	Çregjistro vendbanimin	25.05.2009	14.11.2012
K	Peqin	0 0 0 0	0000	Peqin	Ndrysho venbanimin	25.05.2009	

Fig. nr. 19

Nga klikimi sipas figurës nr. 19 do të shfaqet figura nr. 20, si më poshtë:

(Jo) bllokimi personi

Ndrysho emrin

Ndrysho venbanimin

Cregjistro vendbanimin

Korigjo venbanimin

Familja

Printo certifikatën

Printo ndryshimin e per

Dokumentet e lëshuara

Printo certifikatën histo

Zgjedhje

Përfshirimi nga zgjedh

Anulo veprimin e fundit

Anulo veprimin

Akti i lindjes

Akti i vdekjes

Akti i martesës

Pastrimi i të dhënave

Parametrat

Numrat e HELPDESK

Të dhëna personale

Numri personal **K11119089J**

Emri/mbiemri **Xhuljano Stafa**

Datëlindja/vendlindja **19.11.2001/kavala greqi**

Ndryshuar më **14.11.2012 09:21**

Punonjësi i ZGJC **rudina.brari@moi.gov.a**

organizata **000002**

Pasqyrë e të dhënave të vendbanimit

Arsyeja **Sipas vendimit të gjykatës**

Vendim Nr. 570, datë 16.03.2011 i Gjykatës

Përshkrimi **Rrethit Gjyqësor Elbasan caktohet kujdestar gjyshi i fëmijës Z. Hamit KOKJA**

Lloji i vendb. **Vendbanimi kryesor**

Adresa kryesore/e përkohshme	Adresa jashtë vendit
Rrethi Tiranë	Rrethi
Bashkia/Komuna Tirane	Bashkia/Komuna
Vendi Njesia bashkiake nr. 2	Vendi
Rruga "Mihal Grameno"	Shteti
Numri i ndërtesës 12	
Hyrja 1	Emri i firmës 1
Numri i banesës, apt 0	Emri i firmës 2
Kodi postar 0000	Personi i kontaktit
	Kutia postare
Regjistruar nga 14.11.2012	
Regjistruar përkohësisht deri më	Numri i telefonit 2226802
Qeradhenesi	Numri i celularit 0694130740

Procedura në këtë rast ka përfunduar me sukses.

13. Për shtetasit që ndryshojnë adresën si pasojë e lidhjes së martesës, procedura e ndryshimit të vendbanimit/adresës fillon duke ndjekur të gjitha hapat e parashikuar në gerrat "a", "b", "c" dhe "ç" të pikës 3 të kësaj rregulloreje dhe vazhdon me përzgjedhjen e arsyes: "Sipas aktit të martesës", ku në rubrikën e përshkrimit cilësohet numri i aktit të martesës, data dhe zyra e gjendjes civile ku është lidhur martesa.

E njëjta procedurë do të ndiqet dhe për fëmijët e mitur që shkojnë pas prindërve me martesë, ku pasi përzgjidhet arsyeja "sipas aktit të martesës", në rubrikën e përshkrimit cilësohet "ky fëmijë shkon pas nënës/babait pas lidhjes së martesës".

VENDIM
Nr. 6, datë 23.1.2013

**MBI ANKANDIN E MUAJIT SHKURT 2013 TË KAPACITETEVE TË
INTERKONJEKSIONIT**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 924, datë 26 dhjetor 2012 ka vendosur “Lejimin e shoqërisë KESH sh.a., të importojë energji elektrike për periudhën 1.1.2013 deri 1.3.2013 për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”, si dhe kapitullit X pika 2 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.1.2013, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut

VENDOSI:

1. OST sh.a. t’i alokojë me të drejta të siguruara pa pagesë, shoqërisë KESH sh.a., kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit për muajin shkurt 2013, në drejtim importi, për kryerjen e importit të energjisë elektrike për furnizimin e konsumatorëve tariforë dhe mbulimin e humbjeve në sistemin.

2. OST sh.a. të zhvillojë ankand për muajin shkurt 2013 për kapacitetet e mbetura ndërkufitare, në drejtimin e importit, pas plotësimit të pikës 1 të këtij vendimi.

3. OST sh.a. të zhvillojë ankandin për muajin shkurt 2013 për kapacitetet ndërkufitare në drejtim eksporti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 7, datë 29.1.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“HYDRO POWER PLANT OF KORCA” SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT
PRODHUES PËR “HEC VERBA 1” DHE “HEC VERBA 2” SI BURIM I RINOVUESHËM
ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009 dhe neneve 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 29.1.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hydro power plant of Korca” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “HEC Verba 1” dhe “HEC Verba 2”, si burim i rinovueshëm energjie,



konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Hydro power plant of Korca” sh.p.k., është konform Rregullave dhe Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hydro Power Plant of Korca” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për “HEC Verba 1” dhe “HEC Verba 2” si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 8, datë 29.1.2013

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “A&A GROUP” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f” dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.1.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “A&A Group” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “A&A Group” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “A&A Group” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 9, datë 30.1.2013

MBI ORGANIGRAMËN E RE TË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” (NËN ADMINISTRIM TË PËRKOHSHËM) TË PROPOZUAR PËR MIRATIM ERE-S

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimin nr. 5, datë 21.1.2013 “Për vendosjen e shoqërisë CEZ shpërndarje sh.a., në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë CEZ shpërndarje sh.a., në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 janar 2013 “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a.””, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 30.1.2013, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike të ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e organigramës së shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sipas organigramës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e pagës së administratorit të përkohshëm të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” (në administrim të përkohshëm), në vlerën e 300.000 lekë.


3. Administratori i shoqërisë “CEZ Shpërndarje” (në administrim të përkohshëm) të hartojë strukturën e përgjithshme të shoqërisë “CEZ Shpërndarje”, duke përcaktuar: numrin total të punonjësve, numrin e punonjësve për secilën drejtori dhe sektor, të drejtat dhe detyrat e çdo punonjësi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

ORGANIGRAMA E SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE” (NËN ADMINISTRIM TË PËRKOHSHËM)



VENDIM
Nr. 10, datë 30.1.2013

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f” dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Favina 1” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 11, datë 30.1.2013

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f” dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. datë 30.1.2013, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë



(ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Favina 1” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Favina 1” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 12, datë 30.1.2013

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TRUEN” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGIJËSË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f” dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Truen” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Truen” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Truen” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat prej 30 vjetësh.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 13, datë 30.1.2013

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TRUEN” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE NGA HEC “TRUEN”

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f” dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Truen” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Truen” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Truen” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 14, datë 30.1.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“WONDER” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f” dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Wonder” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Wonder” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Wonder” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 15, datë 30.1.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“WONDER” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f” dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 15, datë 30.1.2013, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Wonder” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Wonder” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Wonder” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 16, datë 30.1.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME SERI PV10K, NR. 112, LËSHUAR ME VENDIM TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 110, DATË 22.12.2010 PËR SHOQËRINË
“ENERGY PLUS” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 germat “a” dhe “b” të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1 germa “a” të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.1.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 112, seria PV10K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 110, datë 22.12.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., plotëson kërkesat ligjore, siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15 pika 4 germa “a”: informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15 pika 4 germa “b”: vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr. 112, seria PV10K, për prodhimin e energjisë elektrike nga hec “Pobreg” me fuqi 9 Mw, të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 110, datë 22.12.2010.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 15, datë 18.1.2013

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO 1”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio 1”, në fushën e transmetimeve radiofonike private vendore.
 2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet nga data 18.7.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM
Nr. 34, datë 1.2.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV SHIJAK”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Prof.As. Endirë Bushati	kryetar
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV Shijak”.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21, neni 33, pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VËREN SE:

Shoqëria “Media +” sh.a., është licencuar nga KKRT-ja, me vendimin nr. 30, datë 14.11.2000 si operator televiziv privat vendor në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për televizionin “TV Shijak”. Me vendimin nr. 698, datë 16.7.2008 është vendosur rinovimi i licencës së subjektit për një periudhë prej 5 vitesh. Licenca e subjektit ka përfunduar në datën 3.1.2011.



Në përfundim të afatit të licencimit, me shkresën nr. 1205 prot., datë 14.9.2010, KKRT-ja ka njoftuar subjektin për përfundimin e afatit, duke i kërkuar depozitimin e dokumentacionit për rinovim. Duke qenë se subjekti nuk kishte depozituar dokumentacion, KKRT-ja në mbledhjen e datës 28.3.2011, ra dakord t'i linte subjektit televiziv "TV Shijak" një afat prej 30-ditësh për depozitimin e dokumentacionit për rinovim licence.

KKRT-ja konstaton se subjekti, përveç mungesës së interesit për rilicencim, ka detyrime të pashlyera ndaj KKRT-së dhe Buxhetit të Shtetit. Në total ky detyrim është 4.184.000 lekë, nga të cilat pagesë për licencë 2.645.600 lekë dhe taksë për shërbimet rtv 1.538.400 lekë.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon se: "Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;

...

5. kërkuesi...nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj".

Në mbështetje të nenit 137/3 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për t'i dhënë mundësi të licencuarit të japë mendime, para marrjes së vendimit për heqjen e licencës, KKRT-ja, me shkresën nr. 112 prot., datë 18.1.2013, ka njoftuar televizionin privat vendor "TV Shijak".

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 1; dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 039/ TVL të subjektit televiziv privat vendor "TV Shijak".
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijeni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu "Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative".
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 19.2.2013
Doli nga shtypi më 20.2.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë